**L I G J**
**Nr.7839, datë 30.6.1994**

**PËR SHPALLJEN E 27 QERSHORIT NË KALENDARIN KOMBËTAR "DITA E GENOCIDIT NDAJ SHQIPTARËVE TË ÇAMËRISË NGA SHOVINIZMI GREK" DHE NGRITJEN E NJE MEMORIALI NË KONISPOL**

Në mbështetje të nenit 16 te ligjit nr. 7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me propozim të një grupi deputetësh,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I :

Neni 1

Dita 27 qershor shpallet në kalendarin kombëtar "DITA E GENOCIDIT NDAJ SHQIPTARËVE TË ÇAMËRISË NGA SHOVINISTËT GREKË".

Neni 2

Të ngrihet në Konispol një Memorial në kujtim të viktimave të këtij genocidi.

Neni 3

Ky ligj hyn në fuqi menjëherë.

**Shpallur me dekretin nr.885, datë 12.7.1994 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Sali Berisha.**